



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 3634 Prot

Lezhë, më 18/03 2026

R A P O R T
PËR VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË PËR VITIN 2025

Të nderuar këshilltarë !

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisjes bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse dhe ligjshmërisë.

Këshilli i Bashkisë Lezhë, gjatë vitit 2025, është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin vëmendjen e duhur, për një shërbim sa më cilësor ndaj komunitetit.

Këshilli ka marrë dhe vendime që i kushtoheshin familjeve me probleme të thella sociale, eliminimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, trajtimin me bursë të nxënësve si dhe vendime për rregullimin e jetës social-kulturore të bashkisë.

Ka marrë vendim çdo muaj për dhënie ndihme ekonomike, për familje, nga fondi i kushtëzuar si më poshtë :

		Ndihmë ekonomike për familje nga Fondi i kushtëzuar 6 %. (Nr. i familjeve)
1	JANAR	86
2	SHKURT	85
3	MARS	80
4	PRILL	81
5	MAJ	83
6	QERSHOR	84
7	KORRIK	83
8	GUSHT	81
9	SHTATOR	82
10	TETOR	81
11	NËNTOR	80
12	DHJETOR	83

Për periudhën Janar – Dhjetor 2025, janë marrë 124 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Lezhë.

Vlen për t'u theksuar se kemi patur dhe vazhdojmë të kemi bashkëpunim korrekt me institucionin e Prefektit të Qarkut për të gjitha vendimet e marra me karakter normativ.

Nga sa thamë më lart, këto vendimmarrje të këshillit, flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë, për t'iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të Bashkisë Lezhë.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka qënë mjaft aktiv, duke mbajtur mbledhjet e radhës, por edhe mbledhje jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë, sipas tabelës së mëposhtme :

Muaji	Nr. i mbledhjeve	Mbledhje të Radhës	Mbledhje jashtë radhe	Mbledhje të Jashtëzakonshme
JANAR	2	1 (27.01.2025)	1 (22.01.2025)	-

SHKURT	1	1 (26.02.2025)	-	-
MARS	1	1 (27.03.2025)	-	-
PRILL	1	1 (30.04.2025)	-	-
MAJ	1	1 (29.05.2025)	-	-
QERSHOR	1	1 (30.06.2025)	-	-
KORRIK	1	1 (29.07.2025)	-	-
GUSHT	0	0	-	-
SHTATOR	2	2 (03.09.2025) (mbledhja e gushtit) (30.09.2025)	-	-
TETOR	1	1 (30.10.2025)	-	-
NËNTOR	1	1 (26.11.2025)	-	-
DHJETOR	1	1 (15.12.2025)	-	-
GJITHSEJ	13	12	1	0

- Vlen të përmendet, kontributi i anëtarëve të këshillit, që janë në përbërje të Komisioneve të Përhershme të këshillit bashkiak, duke veçuar këshilltarët që ndjekin edhe ato komisione ku nuk janë anëtarë.. Komisionet që kanë funksionuar në mirë janë Komisioni i Sigurisë Publike dhe Emergjencave Civile, Komisioni i Bujqësisë dhe Komisioni i Financës, Buxhetit dhe Zhvillimit Strategjik.
- Gjatë vitit 2025 mbledhjet janë transmetuar online në facebook në faqen “Këshilli i Bashkisë Lezhë”.
- Rendi i ditës për çdo mbledhje të këshillit bashkiak, është publikuar të paktën 5 ditë para mbledhjes në web-in e Bashkisë Lezhë si dhe në faqen e Këshillit të Bashkisë Lezhë në Facebook.
- Të gjitha vendimet e këshillit bashkiak, janë publikuar në web-in e Bashkisë Lezhë dhe janë të aksesueshëm nga çdo qytetar pa pagesë.

Në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë ndodhet informacioni i Këshillit Bashkiak për publikun, në një kënd të caktuar nëpërmjet kartelave/tabelave të mëposhtme :

- Të dhëna të përgjithshme për këshillin.
- Anëtarët e Këshillit Bashkiak.
- Sekretari i Këshillit - kontaktet.
- 5 Rregulloret e Këshillit Bashkiak.
- Njoftimet për mbledhjet e këshillit/ projektvendimet
- Njoftimet për konsultimet publike.

- Regjistri i kërkesave dhe ankesave.
- Regjistri i brendshëm i peticioneve.
- Vendimet e këshillit
- Regjistri i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit.

Nga Sekretariati i Këshillit janë vënë në zbatim kërkesat e ligjit për njoftimet publike (*në faqen zyrtare të Bashkisë*), në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Gjithashtu në çdo mbledhje plenare të radhës është lënë një hapësirë për pyetje nga komuniteti (kërkesa apo ankesa), si dhe ato që janë përcjellë përmes pyetjeve që kanë bërë Këshilltarët drejtuar administratës së Bashkisë, të cilat kanë marrë përgjigje të drejtëpërdrejtë nga administrata e bashkisë.

Gjatë vitit 2025 i janë drejtuar KB Lezhë gjithsej 23 kërkesa të cilat kanë marrë përgjigje ose me anë shkresore, ose me vendimmarrje, sipas rastit.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014 “Për konsultimin Publik” gjatë vitit 2025, këshilli ka zhvilluar 13 dëgjesa publike me banorët e Bashkisë Lezhë, në bashkëpunim me administratën dhe kryetarin e bashkisë.

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar takime dhe aktivitete, si në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstytucional, të projekteve që zbaton Bashkia Lezhë, ashtu dhe informuese me shoqërinë civile dhe të rinj.

23 qershor 2025 – Marrëveshja e Binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Komunës së Gjakovës.

Kryetari i Bashkisë dhe një nje perfaqesi e Këshillit Bashkiak në Gjakovë, zhvilluan një takim zyrtar në Komunën e Gjakovës ku u finalizua me Kryetarin Ardian Gjini marrëveshja e Binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Komunës së Gjakovës.

Ky hap i rëndësishëm hap rrugën për një bashkëpunim më të ngushtë në fushat kyçe si Trashëgimia Kulturore, Arsimi dhe Turizmi – fusha që na lidhin historikisht dhe na frymëzojnë për të ardhmen.

9 korrik 2025 – Tryezë Pune mes Këshillave Bashkiakë të Lezhës dhe Mirditës dhe institucionit të Prefektit të Qarkut

Në kuadër të projektit “Bashki të Forta”, u zhvillua një Tryezë Pune mes Këshillave Bashkiakë të Lezhës dhe Mirditës dhe institucionit të Prefektit të Qarkut, me lehtësimin e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).

Në fokus të këtij takimi ishte diskutimi mbi rolin e institucioneve në sigurimin e ligjshmërisë së vendimeve të këshillave bashkiakë, përmirësimi i cilësisë së dokumentacionit shoqëruar dhe rritja e qartësisë institucionale ndërmjet aktorëve vendorë.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të Bashkisë Lezhë e Mirditë, Prefekti i Qarkut, përfaqësues të Ministrisë së Brendshme dhe AMMV, si dhe drejtues e ekspertë të IDM.

Diskutimet e hapura dhe shkëmbimi i përvojave u vlerësuan si hapa të rëndësishëm drejt forcimit të qeverisjes vendore, transparencës dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

30 tetor 2025 - Tetori Rozë

Nismës sensibilizuese të diagnostifikimit të hershëm të kancerit të gjirit, ju bashkuan edhe gratë/vajzat e Këshillit Bashkiak: Një periudhë e rëndësishme për t'u solidarizuar dhe së bashku të bëhemi një zë për shëndetin e grave.

6 nëntor 2025 - Rritja e bashkëpunimit mes Këshillit Bashkiak dhe Shoqërisë Civile

Aktiviteti informues “Bashkëpunimi efektiv ndërmjet Këshillit Bashkiak dhe Shoqërisë Civile”, u organizua me 6 nëntor 2025, nga Këshilli Bashkiak Lezhë në kuadër të projektit “Bashki të Forta” dhe në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).

Ky aktivitet synoi nxitjen e një dialogu të hapur dhe konstruktiv ndërmjet përfaqësuesve të shoqërisë civile, medias, qytetarëve aktivë dhe anëtarëve të Këshillit Bashkiak, me qëllim forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes qytetare në proceset vendimmarrëse vendore.

Në takim morën pjesë anëtarë të Këshillit Bashkiak Lezhë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, aktivistë dhe qytetarë të angazhuar, të cilët ndanë ide dhe rekomandime për përmirësimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet KB dhe grupeve të interesit.

2 dhjetor 2025 - Në 16 ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës, Aleanca e Grave Këshilltareve Bashkiake, vijoi advokimin për më shumë shërbime dhe më shumë buxhete për gratë dhe vajzat.

11 dhjetor 2025 - Ditë e Hapur me të rinjtë e Lezhës – “Zëri i të rinjve në Parlamentin Vendor”

Këshilli Bashkiak Lezhë mirëpriti dhjetëra nxënës nga shkollat e mesme në aktivitetin “Ditë e Hapur: Zëri i të rinjve në Parlamentin Vendor”.

Të rinjtë u njohën me funksionimin e Këshillit Bashkiak – “parlamentin e vogël” të qytetit.

Këshilltarët ndanë përvojat e tyre mbi vendimmarrjen dhe sfidat e përfaqësimit.

U diskutuan mënyrat se si të rinjtë mund të përfshihen në konsultime publike, nisma komunitare dhe mbledhje e hapura të KB.

Nxënësit shtruan pyetje konkrete për rolin e këshilltarëve, procesin e vendimmarrjes, monitorimin e zbatimit të vendimeve dhe mundësitë për t'u përfshirë në punën e Këshillit në të ardhmen. Ky aktivitet u realizua nga Këshilli Bashkiak Lezhë, me mbështetjen e ekspertëve të IDM, në kuadër të projektit “Bashki të Forta”, me qëllim forcimin e transparencës, bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes qytetare në veprimtarinë e KB.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen; gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si: diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimin dhe dhënie me qira të pronave, miratimin e standarteve e rregulloreve etj. me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të komunitetit.

Administratorët e njësive administrative, kryesitë e fshatrave, këshillat komunitare, duhet të bëhen pjesë e organizimit e mbështetjes së dëgjësave publike, ku nëpërmjet posterave, anketave të ndryshme bëhet e mundur tërheqja e mendimit të komunitetit dhe pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje.

Del si detyrë që çdo këshilltar; për aktet normative, për të cilat do të diskutohet dhe vendoset në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publikut në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të.

Bashkëngjitur janë lista e vendimeve për vitin 2025, rezultatet e anketimit vjetor për vlerësimin nga komuniteti, të punës dhe rezultateve të këshillit për vitin 2025 si dhe analiza e audiencës për faqen në Facebook të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

REGJISTËR I VENDIMEVE 2025

Nr	TITULLI I VENDIMIT	Nr. Vendimi	Data	PREPEKTI
1	Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Dhjetor 2024	1	22.01.2025	Akt individual
2	“Për kriteret për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (Fondi 6%) për vitin 2025”	2	27.01.2025	Konfirmim
3	“Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare znj. T.B. dhe z. L.I. për djegie banesë”	3	27.01.2025	Konfirmim
4	“Për një ndryshim në vendimin nr. 74, datë 25.09.2024 “Për miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblymit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave” i ndryshuar”	4	27.01.2025	Konfirmim
5	“Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit “Për vjeljen e detyrimeve të pashlyera nga kundërvajtjet rrugore dhe konvertimin e këtyre vlerave monetare në investim për Policinë e Shtetit”, si dhe formatit të procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes”	5	27.01.2025	Konfirmim
6	“Për miratimin e Planit Vendor të Emergjencave Civile, Bashkia Lezhë”	6	27.01.2025	Konfirmim vetem per permbajtjet
7	“Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private, për ndërtim objekti me funksion kompleks turistik, resort me suita 1,2,3,4 dhe 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë nga shoqëria “Prince Adriatik Resort” shpk dhe shoqëria “Prince Junior” shpk”	7	27.01.2025	Akt individual, kthim pergjigje nga prefektura
8	“Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private, për ndërtim objekti me funksion kompleks banimi dhe shërbimi 5 kate mbi tokë dhe 1, 2 kate nën tokë nga shoqëria “Junik” shpk”	8	27.01.2025	Akt individual, kthim pergjigje nga prefektura

9	“Për një ndryshim në VKB nr. 168, datë 10.07.2017 “Për miratimin e linjave rrethqytetëse, orareve dhe stacioneve të tyre, stacionet e linjave ndërqytetëse, terminalit të transportit të udhëtarëve, si dhe vendet e agjencive të transportit të udhëtarëve brenda vendit””	9	27.01.2025	Konfirmim
10	“Për vendosjen e një statuje në nder të Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, në lulishten përballë Memorialit”	10	27.01.2025	Konfirmim
11	Për heqjen e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë Z. Erin Pjeter Gjoni	11	27.01.2025	Akt individual
12	Për dhënien e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë Z. Pjetër Gjok Gjinkola	12	26.02.2025	Akt individual
13	Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Janar 2025	13	26.02.2025	Akt individual
14	“Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare z. P.Gj. për djegie banesë”	14	26.02.2025	Konfirmim
15	“Për miratimin e akt-marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Kryqit të Kuq Shqiptar, Dega Lezhë”	15	26.02.2025	Shkrese nga prefektura, nuk është akt normativ
16	“Për një saktësim në Lidhjen Nr. 1 të Vendimit nr. 74, datë 25.09.2024 “Për miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblymit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave , i ndryshuar””	16	26.02.2025	Konfirmim
17	“Për një shtesë në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 “Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025” dhe përdorim fondit”	17	26.02.2025	Konfirmim
18	“Për miratimin e Buxhetit Faktik të Bashkisë Lezhë për vitin 2024”	18	26.02.2025	Konfirmim
19	“Për miratimin e Raportit për Vlerësimet dhe Parashikimet Afatmesme të të Ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”	19	26.02.2025	Konfirmim
20	“Për miratimin e Prioriteteve dhe Projekteve për Investime në kuadër të përgatitjes së PBA-së 2026-2028 dhe të Buxhetit të vitit 2026”	20	26.02.2025	Konfirmim
21	“Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin nr. 69, datë 03.09.2024 të Këshillit Bashkiak Lezhë “Për miratim të listës paraprake të pronave të paluajtshme që kërkohen të transferohen në pronësi të Bashkisë Lezhë”	21	26.02.2025	Konfirmim
22	“Për caktimin e shoqërisë “Lezha Invest shpk” si strukturë përgjegjëse për administrimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e plazheve publike”	22	26.02.2025	Konfirmim
23	Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-28 Shkurt 2025	23	27.03.2025	Akt individual
24	“Për një shtesë në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 “Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025”	24	27.03.2025	Konfirmim
25	“Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 “Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025”	25	27.03.2025	Konfirmim
26	“Për miratimin e tavanëve të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2026-2028 (Faza e Parë) të Bashkisë Lezhë”	26	27.03.2025	Konfirmim

27	“Për përdorimin e fondit të emergjencës për mbulimin e shpenzimeve të strehimit (qerasë së banesave) për 4 familje në fshatin Sukaxhi, Njësia Administrative Ungrej”	27	27.03.2025	Shkresë nga prefektura, muk është akt normativ
28	Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Mars 2025	28	30.04.2025	Akt individual
29	“Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare znj. T. V. për djetje banesë”	29	30.04.2025	Konfirmim
30	“Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare z. T.D. për djetje banesë”	30	30.04.2025	Konfirmim
31	“Për miratimin e plan-masave për parandalimin, menaxhimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota si dhe krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve për vitin 2025”	31	30.04.2025	Konfirmim
32	“Për miratimin e dokumentit të nismës për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lezhë”	32	30.04.2025	Konfirmim
33	“Për një korrigjim në Vendimin nr.103, datë 19.12.2024 “Për miratimin e bursave të nxënësve të klasave të X-ta të arsimit të mesëm profesional në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2024-2025”	33	30.04.2025	Akt individual
34	“Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 “Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit për vitin 2025”	34	30.04.2025	Konfirmim
35	Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Prill 2025	35	29.05.2025	Akt individual
36	“Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare z. S.Cj. për djetje banesë”	36	29.05.2025	Konfirmim
37	“Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare z. N.Rr. për djetje banesë”	37	29.05.2025	Konfirmim
38	Për një shtesë në Vendimin Nr. 101, datë 19.12.2024 “Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e qirasë për vitin 2025”	38	29.05.2025	Akt individual
39	Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK	39	29.05.2025	Akt individual
40	Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK	40	29.05.2025	Akt individual
41	“Për lidhjen e marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Lezhë, Shqipëri dhe Komunës Gjakovë, Kosovë”	41	29.05.2025	Konfirmim
42	“Për lidhjen e marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Lezhë, Shqipëri dhe Komunës Spoleto, Itali”	42	29.05.2025	Konfirmim
43	Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore	43	29.05.2025	Akt individual
44	“Për ndryshimin e destinacionit të pronës “Shtëpia e Ushtarakëve”, që është pronë e Bashkisë Lezhë dhe kthimin në fond banesë”	44	29.05.2025	Shkresë nga prefektura,

					nuk eshte akt normativ
45	“Për hapjen e rrugës publike në fshatin Ungrej, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë”		45	29.05.2025	Shkresë nga prefektura, nuk eshte akt normativ
46	“Për miratimin e hapjes së rrugës së varrezave të fshatit Rras, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë, në fondin pyjor bashkiak”		46	29.05.2025	Konfirmim
47	“Për një shtesë në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 “Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit për vitin 2025” dhe përdorim të fondit të kushtëzuar për Emergjencat Civile”		47	29.05.2025	Konfirmim
48	Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Maj 2025		48	30.06.2025	Akt individual
49	“Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare z. D.D. për djegie banesë”		49	30.06.2025	Konfirmim
50	“Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare z. J.G. për djegie banesë”		50	30.06.2025	Konfirmim
51	Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK		51	30.06.2025	Akt individual
52	“Për miratimin e buxhetit faktik për 4-mujorin e parë të vitit 2025”		52	30.06.2025	Konfirmim
53	“Për miratimin e PBA-së 2026-2028 të Bashkisë Lezhë (Faza e Parë)”		53	30.06.2025	Konfirmim
54	Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore		54	30.06.2025	Akt individual
55	“Për miratimin e hapjes së rrugës së lagjes Butem dhe dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar, shoqërisë T&J Construction shpk për ndërtimin e rrugës auto të lagjes Butem, fshati Ungrej, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë”		55	30.06.2025	Konfirmim
56	“Për lidhjen e marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Lezhë, Shqipëri dhe Komunitës San Demetro Corone, Itali”		56	30.06.2025	Konfirmim
57	“Për miratimin e azhormimit të hartës përfundimtare të plazheve të lejuara, vendbazeve ujore dhe zonave e shërbimeve në vijën bregdetare Shëngjin dhe Tale për sezonin turistik veror 2025”		57	30.06.2025	Konfirmim
58	Për heqjen e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Lirim Emin Torba		58	29.07.2025	Akt individual
59	Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Qershor 2025		59	29.07.2025	Akt individual
60	“Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare znj. A.R. për djegie banesë”		60	29.07.2025	Konfirmim
61	“Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare z. Q.G. për djegie banesë”		61	29.07.2025	Konfirmim
62	Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK		62	29.07.2025	Konfirmim
63	“Për disa ndryshime në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 “Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025””		63	29.07.2025	Konfirmim
64	“Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2026-2028 (Faza e Dytë) të		64	29.07.2025	Konfirmim

	Bashkisë Lezhë					
65	Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e interesave të kredisë për vitin 2025	65	29.07.2025	Akt individual		
66	PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS NGA "PESHKATARËT" NË "FRAN PAL DULJ"	66	29.07.2025	Akt individual		
67	PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS NGA " RRUGA STACIONI" NË "SHËN ROZA VENERINI"	67	29.07.2025	Akt individual		
68	PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS NGA " RRUGA E KISHËS" NË "MOTËR CARMELA CATALDO"	68	29.07.2025	Akt individual		
69	PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË LAGJES NGA "POSHTË HEKURUDHE" NË "LAGJJA ARBNORE"	69	29.07.2025	Akt individual		
70	Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Korrik 2025	70	03.09.2025	Akt individual		
71	"Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njëjësive të Vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)"	71	03.09.2025	Konfirmim		
72	"Për miratimin e Planit Vendor Social 2026-2028"	72	03.09.2025	Konfirmim		
73	"Për miratimin e Planit Vendor për Barazi, Përfshirje, dhe pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2025-2030"	73	03.09.2025			
74	"Për miratimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2025-2030"	74	03.09.2025	Konfirmim		
75	"Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028"	75	03.09.2025	Konfirmim		
76	"Për disa ndryshime në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 "Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025"	76	03.09.2025	Konfirmim		
77	"Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Lezhë "Për dhënie në përdorim pa kundërshtim dhe pa afat të objektit "CASA OLA", në Lezhë në funksion të krijimit të Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor"	77	03.09.2025	Konfirmim		
78	PËR KORRIGJIMIN E VKB NR. 68, DATË 29.07.2025 "PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS NGA " RRUGA E KISHËS" NË "MOTËR CARMELA CATALDO" DHE TË MARRË EMRIN "NËNË KARLA BORGERI"	78	03.09.2025	Akt individual		
79	PËR DHËNIEN E MANDATIT SI ANËTAR I KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË Z. GJON ZEF MARKU	79	30.09.2025	Akt individual		
80	"PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % PËR PERIUdhËN 01 – 30 GUSHT 2025"	80	30.09.2025	Akt individual		
81	PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.103, DATË 19.12.2024 "PËR MIRATIMIN E BURSAVE TË NXËNËSVE TË KLASAVE TË X-TA TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2024-2025"	81	30.09.2025	Akt individual		
82	PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.104, DATË 19.12.2024 "PËR	82	30.09.2025	Akt individual		

98	PËR EMËRTIMIN E RRUGËS ME NR. 46 03170040 ME EMRIN "JAK KOVAÇI" NË FSHATIN TRESH, NJËSIA ADMINISTRATIVE ZEJIMEN	98	30.10.2025	Akt individual
99	PËR EMËRTIMIN E RRUGËS ME NR. 60 03170055 ME EMRIN "PIETËR JAK ZEFAJ" NË FSHATIN TRESH, NJËSIA ADMINISTRATIVE ZEJIMEN	99	30.10.2025	Akt individual
100	"PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % PËR PERIUHDHEN 01 – 31 TETOR 2025"	100	26.11.2025	Akt individual
101	"Për një shtesë në Vendimin nr. 74, datë 25.09.2024 "Për miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblymit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave" i ndryshuar"	101	26.11.2025	Konfirmim
102	"Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 "Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025"	102	26.11.2025	Konfirmim
103	"Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për ndërtimin e Qendrës Ditore të Moshës së Tretë në Lezhë"	103	26.11.2025	Konfirmim
104	"Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundravajtësve"	104	26.11.2025	Konfirmim
105	"Për dhënie dhe dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi të bashkisë, për kryerjen e aktivitetit minierar në objektin Gjobardhaj, nga shoqëria "Gjoni" shpk"	105	26.11.2025	Konfirmim
106	PËR MIRATIMIN E SHPËRBLIMIT PËR 20 MATURANTËT ME MESATAREN MË TË LARTË NË MATUREN SHITËTËRORE 2024-2025	106	26.11.2025	Akt individual
107	"Për miratimin e memorandum mirëkuptimi ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) dhe Bashkisë Lezhë, si dhe miratimin e përdorimit të fondeve për organizatat e shoqërisë civile të miratuar me VKB nr. 99, datë 19.12.2024"	107	26.11.2025	Konfirmim
108	"Për miratimin e marrëveshjes së përbashkët ndërmjet Komunitës Cetinje (Prejstonica Cetinje) dhe Bashkisë Lezhë për projektin "SMART LAND 2.0. – Lëvizshmëria e Qëndrueshme e ndërlidhur me Transportin Publik në Zonat Rurale në Adriatikon Jugor"	108	26.11.2025	Konfirmim
109	PËR SHPALLJEN QYTETAR NDERI I BASHKISË LEZHË TË SPORTISTIT JURGEN ULDEDAJ	109	26.11.2025	Konfirmim
110	"Për miratimin e Planit Tematik Vjetor të Këshillit të Bashkisë Lezhë për vitin 2026"	110	26.11.2025	Konfirmim
111	"Për shpalljen e datës 1 Mars si "Dita e Arbërshëve" në Bashkinë Lezhë dhe miratimin e programit vjetor të aktiviteve për këtë ditë"	111	26.11.2025	Konfirmim
112	"Për miratimin e krijimit të Bandës Muzikore të Qytetit"	112	26.11.2025	Konfirmim
113	"Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit për vitin 2026"	113	15.12.2025	Konfirmim
114	"Për miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2027"	114	15.12.2025	Konfirmim
115	"Për lënien në fuqi të tarifave ekzistuese të ujit të pijshëm"	115	15.12.2025	Konfirmim
116	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË SUBVENCIONIN E QIRASË PËR VITIN 2026	116	15.12.2025	Akt individual
117	PËR MIRATIMIN E VLERËS SË GRANTIT TË MENJËHERSHËM PËR 5 FAMILJET PËRFTUESE TË	117	15.12.2025	Akt

	PROGRAMIT TË SUBVENCIONIT TË INTERESAVE TË KREDISË ME VLERË 1 842 784 LEKË			individual
118	PËR MIRATIMIN E BURSAVE TE NXËNËSVE TË REGJISTRUAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE TË AR PARAUNIVERSITAR, PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026	118	15.12.2025	Akt individual
119	PËR MIRATIMIN E BURSAVE TE NXËNËSVE TË KLASAVE TË 10-TA TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026	119	15.12.2025	Akt individual
120	PËR RISHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E BURSIVE TË NXËNËSVE TË VITEVE TË NDËRMJETME, TË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE "KOLIN GJOKA" LEZHË, PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026	120	15.12.2025	Akt individual
121	"Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare znj. N.M për djetje banesë"	121	15.12.2025	Konfirmim
122	"Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare për përmbytje në banesë z. B.Ll., z. L.D., z. Gj.G., z. P.P., z. B.Rr., z. P.T., z. N.K., z. A.M., z. G.D."	122	15.12.2025	Konfirmim
123	"Për krijimin e "Muzeut Arkeologjik Lezhë", në lokalitetin e njohur si "Qafa e Kalasë" dhe pranë "Nekropolit Mesjetar"	123	15.12.2025	Konfirmim
124	"PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % PËR PERIUDHËN 01 – 30 NËNTOR 2025 "	124	15.12.2025	Akt individual

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI
NDUE LULI**

Analiza e Angazhimit: Këshilli Bashkiak Lezhë (Viti 2025)

Viti 2025 ka shënuar një rritje domethënëse në shikueshmëri dhe ndërveprim, duke treguar një interes në rritje të qytetarëve për vendimmarrjen lokale.

1. Pasqyra e Përgjithshme e Arritjes (Reach)

- Shikimet Totale: 160,699 views**, me pika kulminante (spikes) gjatë muajve shkurt, maj dhe nëntor. Këto pika korrespondojnë me periudha kyçe të mbledhjeve të Këshillit ose diskutimeve për buxhetin.
- Struktura e Shikimeve:**
 - 30,945 shikime mbi 3-sekonda.
 - 4,618 shikime mbi 1-minutë (tregues i interesit të lartë për përmbajtje të gjatë, siç janë mbledhjet live).
- Audienca:** Një fakt interesant është se **60.2%** e shikueshmërisë vjen nga "Non-followers", gjë që tregon se postimet kanë arritur të shpërndahen përtej audiencës organike.

2. Ndërveprimi dhe Angazhimi (Engagement)

- Angazhimi Total: 22,215 veprime** (+91.2% krahasuar me vitin paraprak).
- Reagimet:** Dominojnë me **92.1%** të tipit të ndërveprimit, ndërsa janë regjistruar **245 shpërndarje (shares)** dhe **73 komente**.
- Lidhja me Ndjekësit:** Për sa i përket angazhimit (engagement), ndryshe nga shikueshmëria, këtu dominojnë ndjekësit me **60.3%**. Kjo tregon se komuniteti besnik i faqes është ai që ndërvepron më shumë me përmbajtjen.

3. Analiza e Përmbajtjes (Content Type)

Lloji i Përmbajtjes	Shikueshmëria	Angazhimi	Konstatimi
Link (Lidhje)	42.7%	30.4%	Mënyra kryesore e informimit (ndoshta vendime/njoftime).
Reels	33.2%	35.1%	Formati më efektiv për ndërveprim aktiv.
Live	9.1%	17%	Shikueshmëri më e ulët, por angazhim shumë i lartë (pjesëmarrje në mbledhje).
Foto/Multi-photo	15%	13.2%	Përdoren kryesisht për dokumentim vizual.

4. Profili i Audiencës (Demografia)

- Gjeografia:** Dominimi absolut vjen nga **Lezha (70.7%)**, e ndjekur nga Tirana (14.6%) dhe diaspora (Itali 11.4%).
- Gjinia dhe Mosha:**

- **Burrat** përbëjnë shumicën e audiencës aktive (rreth 65-70% në total).
 - Grupmosha më aktive është **35-44 vjeç (33.3%)**, e ndjekur nga 25-34 vjeç (24%). Kjo tregon se faqja ndiqet nga shtresa më aktive e popullsisë që preket drejtpërdrejt nga politikat lokale.
-


Përfundime dhe Rekomandime

1. **Fuqizimi i Reels:** Meqenëse **70.1%** e ndjekësve të rinj vijnë nga formatet video të shkurtra (Reels), sugjerohet që pikat kryesore të mbledhjeve të shndërrohen në klipe të shkurtra informuese.
2. **Rritja e Komunikimit Dy-palësh:** Ndonëse reagimet janë të larta, numri i komenteve (73) mbetet i ulët. Mund të nxiten diskutime publike përmes pyetjeve direkte në postime.
3. **Targetimi i Diasporës:** Me mbi 11% të audiencës në Itali, faqja shërben si një urë lidhëse e rëndësishme për bashkëatdhetarët që duan të informohen për vendlindjen.

Rezultatet e pyetësorit “Për vlerësimin e punës së Këshillit Bashkiak 2025”, i administruar përmes faqes zyrtare në Facebook të Këshillit Bashkiak Lezhë gjatë periudhës 23 shkurt – 1 mars 2026.


1. Zona juaj e banimit është:

50 responses




2. Gjinia:

50 responses




3. Grupmosha:

50 responses




4. Në përgjithësi, si e vlerësoni punën e Këshillit gjatë vitit 2025?

50 responses




5. A i keni ndjekur mbledhjet e Këshillit Bashkiak të transmetuara drejtpërdrejt në Facebook gjatë vitit të kaluar?

50 responses




6. Si e vlerësoni transmetimin drejtpërdrejt të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak?

50 responses




7. Si e vlerësoni publikimin e akteve dhe dokumentacionit të Këshillit Bashkiak?

50 responses




8. Gjatë 2025, si e vlerësoni procesin e dëgjësave publike të organizuara nga Këshilli Bashkiak para vendimmarrjes?

50 responses



9. A i jeni drejtuar këshillit të bashkisë me ndonjë kërkesë apo ankesë gjatë vitit 2025?


50 responses



- I kam drejtuar kërkesë dhe më është përgjigjur
- I kam drejtuar kërkesë dhe nuk kam marrë përgjigje
- Këshilli dhe këshilltarët nevojitet të jetë më aktiv në shqyrtimin e kërkesave ndaj qytetarëve
- Nuk kam drejtuar asnjë kërkesë tek këshilli

10. Si e vlerësoni vendimmarrjen e këshillit gjatë vitit 2025?


50 responses



- Kryesisht në interes të komunitetit
- Pjesërisht në interes të komunitetit
- Kryesisht jo në interes të komunitetit
- Aspak në interes të komunitetit
- Nuk kam informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar


11. Si e vlerësoni punën e këshilltarëve të KB për vitin 2025?

50 responses




12. Mendoni se këshilltarët kanë përfaqësuar gjatë vitit 2025:

50 responses



13. Si e vlerësoni atmosferën e punës në Këshillin Bashkiak?


50 responses



- Të qetë dhe miqësore
- Të tensionuar dhe me debate të shpeshta
- Normale, me diskutime dhe vendimmarrje të balancuara
- Nuk e di

14. Sa të përfaqësuar ndiheni nga ndonjë këshilltar apo grup këshilltarësh që mbrojnë interesat tuaja apo të fshatit/Njësisë Administrative/ lagjes tuaj?


50 responses



- Shumë i/e përfaqësuar
- Mjaftueshëm i/e përfaqësuar
- Pak i/e përfaqësuar
- Aspak i/e përfaqësuar
- Nuk e di

15. A jeni të informuar se si mund të kontaktoni anëtarët e Këshillit Bashkiak për të shprehur shqetësimet tuaja?


50 responses



- Po, jam plotësisht i/e informuar
- Po, pjesërisht
- Jo, nuk jam i/e informuar
- Nuk e di

16. Kujt do t'i drejtoheshit për të zgjidhur shqetësimet tuaja?

50 responses



- Administratës së Bashkisë
- Këshillit Bashkiak
- Të dyja bashkë
- Nuk e di